



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

---

Anr.29/2025

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli, kryesues, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, (AAK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Vendimi Nr.01/33-2025, të datës 08.01.2025, për shkak të refuzimit për ndarjen e mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, për periudhën nga 1 Janari 2025 deri me 28 Shkurt 2025 për Financimin e Subjekteve Politike, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.01.2025, mori këtë:

#### V E N D I M

**Hedhet poshtë e palejuar** ankesa Anr.29/2025 e datës 13.01.2025, parashtruar nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, (AAK) me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.01/33-2025, të datës 08.01.2025, për shkak të refuzimit për ndarjen e mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, për periudhën nga 1 Janari 2025 deri me 28 Shkurt 2025, për Financimin e Subjekteve Politike, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025.

#### A r s y e t i m

Me datën 13.01.2025 subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, (AAK), ka paraqitur ankesë në PZAP, me të cilin kundërshton Vendimin e KQZ-së, Nr.01/33-2025, të datës 08.01.2025, lidhur me refuzimin e rekomandimit të Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike mbi Caktimin e Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, për periudhën 1 janar 2025 deri me 28 Shkurt 2025.

Më tej parashtruesi i ankesës thekson se vendimi i kontestuar është nxjerr përmes mos aplikimit të duhur të dispozitave ligjore dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike. Të metat e tilla të vendimit parashtruesi thekson se qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për

Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031, të cilat konsistojnë në faktin se me nenin 48 paragrafi 1 të këtij ligji është paraparë se Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë dhe se i njëjti duhet të përmbajë: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.

Andaj thekson se vendimi i KQZ-së, është i paqartë dhe kundërthënës me vetveten ngase i njëjti vendim nuk përmban elemente, siç përcaktohet me nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që pala ti kuptoj arsyet e refuzimit të kërkesës apo ankesës së saj dhe se nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Po ashtu thekson se në nenin 48.2, të po të njëjtit ligji përcaktohet se:

“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm është i barabartë me mungesën e tij.

Më tutje në ankesë thekson se KQZ-ja, në mbledhjen e datës 08.01.2025 nuk ka arritur që të marr vendim për Caktimin e Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike parlamentare për periudhën dy mujore Janar – Shkurt 2025 dhe se në mungesë të arsyetimit të elaboruar në pikat e lartcekura konsideron se kriteri për të përfituar nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, janë plotësuar në plotni. Për shkak të cenimit të interesave juridike të subjektit politik AAK, nga refuzimi i kërkesës së tillë, në kundërshtim me nenin 8 të Ligji për Financimin e Subjekteve Politike, po pamundësohet financimi i aktiviteteve të subjektit politik AAK, financimi i degëve të subjektit politik, financimin për shpenzime materiale vjetore të deputetëve dhe punën e Grupeve Parlamentare për aktivitetet partiake, si dhe shpenzimet për zgjedhjet Lokale dhe Qendrore dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme të subjekteve politike.

Me tutje në ankesë theksohet se në mungesë të arsyetimit nga Komisioni Qendror të Zgjedhjeve presupozohet se gjendja faktike nuk është vërtetuar siç duhet dhe se organi administrativ gabimisht ka vërtetuar faktet vendimtare, përkatësisht faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare.

Mbi bazën e të cekurave më lartë, AAK propozon që ankesa të shpallet si e bazuar dhe se vendimi i KQZ-së, është i kundërligjshëm, Rekomandimi i Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike në KQZ, të aprovohet sipas shumave të parapara që u takojnë subjekteve politike, në rastin konkret edhe subjektit ankimues.

PZAP, me datë 13.01.2025 iu është drejtuar me kërkesë për përgjigje KQZ-së, lidhur me ankesën A.nr 29/02025, të parashtruar nga AAK, KQZ me datë 14.01.2025, është përgjigjur në ankesë ku thekson se: Sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 3 të Rregullores Nr.03/2024 për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen Financiare të Subjekteve Politike, Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollim Financiar të Subjekteve Politike (ZRKSFSP) në mbledhjen e KQZ me Nr.02/2025 të datës 08.01.2025, ka rekomanduar që 14 subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës të ju ndahen mjete financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike.

Në përgjigje po ashtu theksohet se rekomandimi i ZRCKFSP ka përmbajtur shpjegimin e shkruar për secilin subjekt politik si :” *Konform paragrafit 2 të nenit 7 të Ligjit për Financimin e*

*Subjekteve Politike, Fondi për mbështetjen e subjekteve politike funksionon në kuadër të KQZ-së, dhe rrjedhimisht pas pranimit të rekomandimit nga Zyra, KQZ me vendim, miraton ose refuzon rekomandimin e Zyrës”.*

KQZ, pas diskutimeve lidhur me rekomandimin dhe votimin e të njëjtit nuk ka marr votat e mjaftueshme për miratimin e rekomandimit, respektivisht 3 vota ishin për, të cilat ishin të pamjaftueshme për të miratuar rekomandimin.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi, vëren se e njëjta është e pa lejuar. Për të vlerësuar lejueshmërinë e paraqitjes së ankesës, paneli iu referuar Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, nenit 119 paragrafi 3, me të cilin është përcaktuar se “PZAP-i vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj.” Ndërsa kundër të cilave vendime të KQZ-së mund të ushtrohet ankesë është specifikuar me nenet, 27.6, 39.3, 41.5, 46, 51.4, 54.8, 69.7, 77.5, 80.3, 94.2, 98.3, 100.3, 102.1, 103.4 dhe 105.1, si dhe ato të cilat janë të përcaktuara në nenin 9, të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave.

Sipas vlerësimit të Panelit, nga interpretimi i dispozitave të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nuk përcaktohet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohen vendimet e kësaj natyre të KQZ-së, përkatësisht, vendimi i KQZ-së, për ndarjen e mjeteve nga fondi për mbështetjen e subjekteve politike, në këtë kuptim, paneli vlerëson se rasti lëndor nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP, e rrjedhimisht nga kjo edhe ankesa është e palejueshme.

Prandaj, nga arsyet e paraqitura si më lart, në pajtim me nenin 13 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, si dhe nenit 119 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejueshme.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

**A.nr.29/2025, datë 15.01.2025**

**Kryesuese e Panelit**

**Kujtim Pasuli**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.